



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 371 Prot

Tiranë, më 24, 12, 2014

VENDIM Nr. 363 datë 12.12.2014

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 12.12.2014, pasi shqyrtoi "Relacion Paraprak mbi Gërmimin Arkeologjik të Shpëtimit", në kuadër e të projektit " Shëtitore e bregut të Drinit-Lezhë", realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me DRKK Shkodër,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Relacionin Paraprak mbi Gërmimin Arkeologjik të Shpëtimit", në kuadër të projektit " Shëtitore e bregut të Drinit-Lezhë ", të realizuar deri në këtë fazë.
- II. Të restaurohen dhe evidentohen të dy strukturat e mureve, të gjetura në zonën pranë urës së hekurit, buzë lumit Drin, në anën veriore të lagjes " Skënderbeg". Të realizohet sistemimi dhe gjelbërimi i territorit ku është gërmuar.
- III. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja e vazhdueshme arkeologjike, nga arkeologët e DRKK Shkodër, në bashkëpunim me arkeologët e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- IV. Bashkia e Lezhës gjatë hartimit të projektit për shtrimin dhe sistemimin përfundimtar të Shëtitores së bregut të Drinit-Lezhë, duhet të ruajë dhe integrojë strukturat e sipërpërmendura brenda tij.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO